



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Nr i dok. 23.8.1-2009-08

RAPORT FINAL I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMPANISË SË UJËSJELLËSIT RAJONAL

“PRISHTINA” PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2009

Prishtinë, Qershor 2010

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Përmbledhje e përgjithshme
2. Hyrje
3. Fushëveprimi i auditimit
4. Qasja e Auditimit
5. Opinioni i Auditimit
6. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
7. Historiku
8. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit
9. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Kompanisë

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e KUR Prishtinës dhe Vlerësimet e ZAP-it

Lista e Shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AKM	Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
KUR	Kompania e Ujësjesit Rajonal
LNP	Ligji për Ndërmarrjet Publike
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Ministria)
NJMNP	Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NP	Ndërmarrje Publike
SKK	Standardet Kosovare të Kontabilitetit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SNRF	Standardet Ndërkombëtare mbi Raportimin Financiar
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë së Ujësjetës Rajonal "Prishtina" për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2009.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të hartuara nga INTOSAI, dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare.

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të KUR Prishtina me 31 Dhjetor 2009 dhe operacioneve të saja financiare gjatë vitit të njëjtë. Si theksim i çështjes ne dëshirojmë t'ju tërheqim vëmendjen sa i përket paraqitjes së të arkëtueshmeve dhe vlerësimit të provizioneve për borxhet e këqija. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Më tutje auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i kompanisë. Dobësitë kryesore të menaxhimit i kemi paraqitur në vijim:

1. Softueri i kompanisë nuk ofron siguri të plotë në procesimin e të dhënave, ku si pasojë kanë ndodhur një numër i konsiderueshëm i gabimeve në faturat e lëshuara;
2. Angazhime të punësuarve jashtë listës së pagave, të cilët paguhën nga arka dhe nuk kanë kontrata të nënshkruara valide me kompaninë;
3. Nuk bëhet vlerësimi vjetor i performancës për personelin e kompanisë;
4. Procedurat e prokurimit nuk ishin zhvilluar në përputhshmëri të plotë me LPP-në. Rrjedhimisht janë përzgjedhur fituesit në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme, si dhe ka munguar një mbikëqyrje e duhur në realizimin e kontratave;
5. Realizim i ulët i planifikimit të prokurimit për vitin 2009 (rreth 30%), pjesa tjetër e shpenzimeve janë bërë jashtë planifikimit të prokurimit;
6. Moduli i mjeteve themelore përmban mjete themelore të cilat janë në vlerë më të vogël se 500€, e cila bie në kundërshtim me Rregulloren për udhëheqjen e librave në KUR Prishtina. Totali i këtyre mjeteve është 218,083€; dhe
7. Kompania nuk ka arritur të nxjerr dhe të kompletoj të gjitha rregulloret për funksionimin e brendshëm të cilat kërkohen me ligjin për NP-të.

Ne e kemi rekomanduar Bordin e KUR Prishtina të fillojë menjëherë me një program që ka për qëllim forcimin e kontroleve të brendshme dhe përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit financiar të organizatës.

Menaxhmenti i KUR Prishtina është pajtuar më të gjeturat dhe konkludimet tona në raportin e auditimit për pasqyrat financiare dhe është zotuar se do të bëjë përpjekje të implementoj të gjitha rekomandimet e dhëna në këtë raport.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Bordi i Kompanisë së Ujësjetës Rajonal Prishtina është përgjegjës para Ministrit të MEF-it, si përfaqësues i pronarit (Republikës së Kosovës).

Përgjegjësia kryesore lidhet me prezantimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimin financiar në bazë të parimit akrual të kontabilitetit.

Ndërsa Qeveria nëpërmjet Ministrit të MEF-it i përgjigjet Kuvendit në baza vjetore lidhur me performancën e NP-ve Qendrore.

III. Objektivi dhe Fushëveprimi i Auditimit

Auditimi i KUR-Prishtina ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2009.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse Pasqyrat Financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

IV. Qasja e Auditimit

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adoptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht.

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në katër fusha kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit e Entitetit – të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin si dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me legjislacionin;
- Kontrollat e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, ne kërkojmë të identifikojmë kontrollet menaxheriale dhe monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe; dhe
- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike – për të ofruar një siguri të kërkuar të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollet e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punës sonë sipas kontrolleve të brendshme të menaxhimit të theksuara më lart, në dokumentojmë kontrollet e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, (siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalosja, keq deklarimi, përfshirja ose lënie jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

Sipas qasjes sonë të rishikuar të auditimit, ne ndërmorëm një auditim të parakohshëm përgjatë këtij viti. Auditimi i parakohshëm duhet të kuptohet si një auditim që fillon nga viti fiskal që është nën auditim me qëllim të dhënies së rekomandimeve mbi atë se si:

- mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;
- të përgatiten Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

Këtë vit ne kemi raportuar konkluzionet dhe rekomandimet tona nga auditimet e parakohshme në Memorandumet e Auditimit, në Janar të vitit 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e KUR-Prishtina ne kemi ndërmarr aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar Pasqyrat Financiare të KUR-Prishtina;
- Kemi përcaktuar nëse Pasqyrat Financiare të Kompanisë janë përgatitur në pajtim me SKK - SNK;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit, shtresimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
- Kemi analizuar menaxhimin financiar brenda organizatës; dhe
- Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Auditimit të Brendshëm në KUR-Prishtina.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të KUR Prishtina, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

V. Opinioni i Auditimit

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të KUR Prishtina me 31 Dhjetor 2009 dhe operacioneve të saja financiare gjatë vitit të njëjtë.

Si theksim i çështjes ne dëshirojmë t'ju tërheqim vëmendjen sa i përket paraqitjes së të arkëtueshmeve dhe vlerësimit të provizioneve për borxhet e këqija. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Kompanisë i ka munguar një politikë e mirë e njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Gjatë periudhës prej vitit 1999 e deri në vitin 2009 kompania nuk kishte arritur një inkasim të kënaqshëm të mjeteve të saj. Afro 80% e mjeteve të painkasuara kompania i kishte provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta. Kjo paraqitje nuk ishte bërë në pajtim të plotë me standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme vendore.

VI. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara

Auditimi i Pasqyrave Financiare të KUR Prishtina për vitin 2008 është kryer nga kompania private e auditimit Audit & Konto që ishte kontraktuar në përputhje me Ligjin e NP-vë. Kjo kompani në Letër Menaxhmentin për KUR-Prishtina kishte dhënë dhjetë (10) rekomandime kryesore. Prej tyre shtatë (7) janë në proces të adresimit, ndërsa tri (3) nuk janë adresuar.

Rekomandimet të cilat nuk kanë arritur të adresohen janë:

- Rekomandimi që Kompania të bëjë analizë dhe trajtim të duhur të arkëtueshmeve, si dhe vlerësim të drejtë të provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta;
- Rekomandimi që Kompania të bëjë vlerësimin vjetorë të stafit të saj; si dhe
- Rekomandimi që të nxjerrë rregullore dhe udhëzime të shkruara, të mjaftueshme për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Dështimi në implementimin e plotë të rekomandimeve të kaluara është tregues se në Kompani ende ekzistojnë problemet e njëjta edhe këtë vit.

VII. Historiku

Pas vitit 1999 ish Ujësjiellësi Rajonal "Batllava" i nënshtrohet një transformimi dhe konsolidimi regjional, dhe në vitin 2007 përfundimisht shndërrohet në Shoqëri Aksionare me emërtimin: Kompania Ujësjiellësi Rajonal "Prishtina"-Sh.A. Pronar i kësaj kompanie në fillim ishte Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, ndërsa pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës aksionar i vetëm është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Me rastin e korporatizimit më 1 Janar 2007 kompania ka hapur librat duke filluar më Bilancin fillestar, pas vlerësimit që i është bërë kompanisë nga Grant Thornton Consulting DOO Maqedoni – Shkup ("Konzorciumi"), të cilën e kishte angazhuar AKM-ja.

KUR "Prishtina" sh.a. ofron shërbime të furnizimit të ujit të pijes dhe menaxhimit të ujërave të zeza në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Lipjan, Podujevë dhe Gillogoc.

Baza ligjore e Kompanisë pas korporatizimit është Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, ndërsa organizimi si Shoqëri Aksionare është bërë në përputhje me ligjin mbi Shoqëritë Tregtare.

Kompania Qeveriset nga Bordi i Drejtoreve, ndërsa menaxhohet nga Drejtori ekzekutiv i cili është përgjegjës ndaj Bordit. Bordi është përgjegjës ndaj Ministrisë të MEF-it si përfaqësues i Qeverisë.

Financimi kryesor i saj është gjenerimi i të hyrave nga aktiviteti i shitjes së ujit dhe kanalizimit. Tarifat e shitjes së ujit, kanalizimit dhe tarifës fikse përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

Përgjegjësia e jonë është të kryejmë auditimin vjetor të Pasqyrave Financiare dhe të raportojmë tek Bordi i Kompanisë dhe publiku në lidhje me kualitetin e informatave në këtë raport dhe menaxhmentin Financiar të Kompanisë.

VIII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

VIII. 1 Rezultati financiar në raport me Buxhetin e Aprovuar

Një analizë e rezultatit financiar për Të hyrat, Shpenzimet në raport me Buxhetin e Aprovuar

Tabela: Pamja e buxhetit – Të hyrat dhe shpenzimet

Përshkrimi i kategorisë	Planifikimi për vitin 2009	2009	2008
Të hyrat nga shërbimet e furnizimeve me ujë	10,649,472	9,970,073	9,147,772
Të hyrat tjera operative	61,950	106,162	254,083
Të hyrat nga grantet		49,949	30,411
Të hyrat operative	10,711,422	10,126,184	9,432,266

Shpenzimet e personelit	3,060,618	2,718,445	2,781,247
Shpenzimet e energjisë	1,396,461	1,972,240	1,486,878
Shpenzimet e karburanteve	89,382	173,034	198,772
Shpenzimet materiale	293,036	488,814	790,043
Shërbimet e jashtme kontraktuese	416,050	552,341	275,583
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	657,434	156,683	149,966
Vlera furnizuese e materialit- uji i blerë		81,994	84,509
Shpenzimet e rekreacionit		31,764	3,631
Shpenzimet e zhvlerësimit		3,447,577	3,335,042
Shpenzimet e borxhit të keq	3,709,438	2,819,699	2,938,764
Të dalat financiare dhe transferet		22,562	4,440
Gjithsej Shpenzimet Operative	12,619,419	12,465,153	12,048,877

Fitimi - Humbja Operative	-2,338,969	-2,616,611
---------------------------	-------------------	-------------------

Shpenzimet operative për vitin 2009 të aprovuara në planin e biznesit 2009-2013 ishin 5,912,981€ (këtu nuk janë përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit dhe shpenzimet e borxheve të këqija). Ndërsa shpenzimet operative aktuale për vitin 2009 janë 6,197,877€, që ka një tejkalim të buxhetit për 284,896€ apo 4.8%.

Rritje të theksuar ka pasur në shpenzimet e energjisë për shkak të ndryshimit të faturimit nga KEK-u.

Dyfishimi i shpenzimeve për shërbimet e jashtme kontraktuese është për shkak se kompania këtë vit kishte paguar 252,523€ tatim në pronë në krahasim më vitin 2008 që janë shpenzuar 11,149€.

Ndërsa mungesa e prezantimit të vlerave në kolonën e planifikimit, është për arsye se kompania pas miratimit të buxhetit kishte vendosur paraqitjen e shpenzimeve në formë më analitike.

Tabela: Pamja e Bilancit të gjendjes

Përshkrimi	Viti 2009	Viti 2008
Prona, Impiantet dhe Pajisjet	59,943,234	62,403,508
Stoqet Neto	1,401,165	1,283,765
Llogaritë e Arkëtueshme	7,994,645	6,707,693
Kërkesat tjera	528,769	703,205
Paraja dhe Ekuivalentet e Parasë	895,118	977,471
Totali i pasurive	70,762,931	72,075,643
Kapitali Aksionar dhe rezervat (Humbjet) e Akumuluar/ humbja e vitit	72,645,753 (8,434,556)	72,645,753 (6,091,976)
Total ekuiteti	64,211,198	66,553,778
Grantet e Shtyra	873,617	578,375
Llogaritë e pagueshme dhe tatimi i pagueshëm	5,678,116	4,943,489
Total Detyrimet	6,551,733	5,521,864
Total Detyrimet&Ekuiteti	70,762,931	72,075,643

Nga pasqyra e bilancit të gjendjes së paraqitur më lartë vërehet se KUR Prishtina vite me radhë është duke operuar me humbje, andaj menaxhmenti i Kompanisë duhet të merr veprime konkrete për rimëkëmbjen e Kompanisë.

VIII. 2 Pasqyrat Financiare

2.1. Cilësia e informatave

Kompania është e obliguar që Pasqyrat Financiare ti përgatitë në përputhje me SKK - SNK, në pajtim me ligjet aplikative në Kosovë si dhe me Udhëzimet e Thesarit.

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po u raportojmë ato në pajtim me ISSAI 1260:

- Trajtimi i të arkëtueshmeve dhe provizionimi i borxheve të këqija dhe të dyshimta nuk ishte paraqitur në pajtim të plotë me standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme.

Përveç këtyre, janë identifikuar edhe disa çështje tjera më pak të rëndësishme:

- Softueri i kompanisë nënvlerëson të arkëtueshmet në vlerë prej 99,543€, për arsye se kjo vlerë gabimisht raportohet më minus në softuer;
- Kompania gjatë vitit 2009 ka bërë shlyerjen e të arkëtueshmeve për konsumatorë në vlerë prej 289,124€, e cila nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare; dhe
- Moduli i mjeteve themelore përmban pajisje apo mjete themelore të cilat janë në vlerë më të vogël se 500€; totali i këtyre është 218,083€.

2.2. Pajtueshmëria në lidhje më raportimin financiar

Kompania kishte arritur të përgatisë pasqyrat financiare duke përfshirë pesë komponentët e kërkuara sipas standardeve të kontabilitetit dhe ligjeve të aplikueshme vendore. Megjithatë disa zëra në pasqyrat financiare (trajtimi i të arkëtueshmeve dhe provizionimi i borxheve të këqija dhe të dyshimta) nuk ishin trajtuar në pajtim të plotë me këto standarde dhe ligjet e aplikueshme.

Ndërsa zbatimi i Udhëzimeve të Thesarit dhe LMFPP mbetet e pa arritur për shkak të kundërthënies në Parimet Kontabël në përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Të rishikohet çështja e të arkëtueshmeve dhe provizioneve për borxhet e këqija në bashkëpunim me organet qendrore përkatësisht aksionarët e saj; si dhe
- Bordi në koordinim me Ministrin e MEF-it të qartësoj pozitën e Kompanisë ndaj detyrimeve të sajë rreth zbatimit të LMFPP dhe Udhëzimeve të Thesarit.

VIII. 3 Ekzekutimi i Buxhetit

3.1. Menaxhimi i të hyrave

Të hyrat e raportuara në Pasqyrat Financiare për vitin 2009 janë 10,126,183€. Prej tyre 9,970,073€ janë nga shitja e ujit, 49,949€ nga grantet e fituara, si dhe 106,162€ janë nga të hyra tjera të kompanisë.

Në vitin 2009 të hyrat nga shërbimet e ujit dhe kanalizimit janë rritur për 822,301€ në raport me vitin 2008, përkatësisht 9%. Rritja e të hyrave ishte si rezultat i rritjes së klientëve.

Në auditimin e të hyrave ne kemi shfrytëzuar programin e auditimit IDEA, me të cilin kemi testuar në përgjithësi procesin e faturimeve deri të faza e inkasimit të mjeteve. Po ashtu në detaje kemi testuar 45 mostra duke u bazuar në numrin e konsumatorëve. Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat në vijim:

Prezantim dhe vlerësim jo i drejte i inkasimit vjetor

Inkasimi i raportuar nga Kompania për vitin 2009 ishte 6,457,950€, Kjo vlerë nuk ishte shpalosur në pasqyrat financiare se sa prej tyre u takojnë të hyrave të vitit 2009, e sa prej tyre të hyrave nga borxhet e viteve paraprake.

Inkasime të mjeteve financiare nga inkasantët që nuk kanë kontrata me KUR Prishtinën

Në rrjetin e KUR Prishtina ka pasur kyçje ilegale në periudhën e pasluftës. Këto kyçje janë bërë nga disa fshatra të cilat kanë investuar në rrjetin e fshatit më mjete vetjake, pastaj janë kyçur në rrjetin e ujit të Kompanisë në mënyre ilegale. Menaxhmenti i KUR Prishtina ka bërë marrëveshje joformale me këto fshatra që inkasantët të caktohen prej fshatrave që të mbledhin të hyrat për KUR Prishtinën në ato pjesë. Për më tepër kompania nuk ka lidhur kontratë me këta inkasantë dhe pagesat e tyre janë bërë nga arka.

Gabime në procesin e faturimit dhe sistem (softuer) jo i besueshëm i faturimit

Softueri i kompanisë nuk ofron siguri të plotë në procesimin e të dhënave, ku si pasojë ka një numër të konsiderueshëm të gabimeve në faturat e lëshuara.

Testimet tona kanë treguar se prej 902,139 faturave të lëshuara nga kompania, një pjesë e tyre (afro 30%) përmbajnë gabime teknike. Këto gabime janë vërejtur të çmimi i ujit, çmimi i kanalizimit dhe tarifa fikse. Po ashtu kemi vërejtur se në disa raste janë lëshuar fatura më numër të njëjtë serik. Gabimet e lëshuara janë si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve të mjaftueshme rreth vërtetimit të leximit të ujëmatësve, e disa vijnë si rezultat i procesimit të të dhënave nga softueri.

Pas testeve detaje kemi vërejtur se gabimet e lëshuara janë gabime teknike dhe nuk kanë pasur ndikim financiar në rezultatin e kompanisë.

Konkluzioni

KUR Prishtina nuk ka arritur ta ketë në kontroll tërë rrjetin e saj, për të cilin është dashur të hyjë në marrëveshje me disa fshatra lidhur me inkasimin e mjeteve. Si rezultat i kësaj KUR Prishtina ka bashkë menaxhuar rrjetin e ujit (pjesa e investimit të fshatrave) me banorët e fshatrave përkatëse.

Po ashtu si pasojë e paraqitjes së gabimeve të ndryshme në procesin e faturimeve kompania është përballur me shumë ankesa nga konsumatorët të cilat kanë rezultuar më shlyerje të borxheve rreth 289,124€ për vitin 2009.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Të bëjë shpалosjen e inkasimeve në mes të të hyrave nga viti aktual dhe inkasimeve nga borxhet e viteve paraprake;
- Të legalizohet rrjeti i ujit nëpër fshatra, në mënyrë që kompania ta ketë plotësisht nën kontroll atë pjesë;
- Menaxheri ekzekutiv i shitjes të sigurojë që raportet e inkasantëve lidhur me shpërndarjen e faturave dhe leximin e ujëmatësve të kontrollohen dhe të nënshkruhen me rastin e pranimit të tyre; dhe
- Të avancohet softueri nga personi përgjegjës në mënyrë që të parandalohen gabimet që rrjedhin gjatë procesit të faturimeve.

3.2. Menaxhimi i shpenzimeve

3.2.1. Pagat

Planifikimi i shpenzimeve për paga dhe meditje gjatë vitit 2009 ishte 3,060,618€, ndërsa shpenzimet aktuale të pagave ishin në vlerë prej 2,718,445€, me një diferencë prej 342,173€. Arsyeja e mos realizimit të buxhetit për paga dhe meditje ishte mosarritja e ngritjes së pagave në nivelin e skemës së planifikuar për personelin e saj.

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2009 ishte 495. Prej tyre ne testuam 38 dosje të personelit duke u bazuar në mostrimin tonë sipas programit të auditimit.

Të gjeturat

Të punësuarit jashtë listës së pagave

Për vitin 2009, pasqyrat financiare kanë prezantuar shpenzimet e pagave në vlerë prej 2,718,445€. Ndërsa sipas listës së pagave këto shpenzime ishin në vlerë prej 2,681,466€, që kishte rezultuar me një diferencë prej 36,978€. Diferenca ka rrjedhë nga pagesat e pagave për inkasantët e fshatrave që nuk janë futur në listën e pagave. Këta inkasant nuk kishin kontrata të nënshkruara për marrëdhënie pune më kompaninë, si dhe nuk ishin paguar obligimet tatimore për pagat e tyre.

Konkluzioni

Konkludimi ynë është se menaxhmenti i kompanisë nuk ka arritur të siguroj kontrole të mira në Burimet Njerëzore. Departamenti përgjegjës nuk ka arritur të siguroj kontrata të nënshkruara me një pjesë të stafit të saj duke mos paguar obligimet tatimore për paga si dhe duke bërë pagesën e pagave të tyre përmes arkës.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Të gjithë të punësuarit e saj të futen në listën e pagave, dhe të kryej të gjitha obligimet tatimore që rrjedhin lidhur me këto shpenzime; dhe
- Të jetë e nënshkruar çdo kontratë nga punëtorët dhe punëdhënësi duke përcaktuar autorizimet, obligimet, të drejtat dhe përgjegjësitë ligjore.

3.2.2. Mallrat dhe shërbimet

Pasqyrat financiare të kompanisë kanë raportuar shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë prej 3,479,432€. Prej tyre ne kemi testuar disa kontrata të cilat kanë përfshire afro 25% të këtyre shpenzimeve.

Të gjeturat

Përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre ofertuesve të përgjegjshëm

Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit kemi identifikuar dobësi në procesin e vlerësimit të ofertave. Këto dobësi janë vërejtur te kontratat:

- **Mirëmbajtja e Automjeteve** në të cilën kanë munguar tri oferta të përgjegjshme, pasi që njëri nga ofruesit nuk kishte plotësuar në tërësi dosjen e tenderit; dhe në kontratën,
- **Furnizim me Material Administrativ** kanë munguar tri oferta të përgjegjshme, pasi që asnjëri prej ofruesve nuk kishte plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes. Atyre u mungonin certifikatat valide për kualitetin e prodhimeve sipas Standardeve Ndërkombëtare.

Menaxhim jo i mirë i shpenzimeve të servisimit

Në kategorinë e shpenzimeve të servisimit ne kemi testuar vlerën prej 15,675€ në kontratën për shpenzime të automjeteve. Në këtë kontratë kemi vërejtur se kompania fituese kishte manipuluar në specifikacionin teknik të ofertës në të cilën kishte ofruar artikuj me çmime zero euro (Bosh Pompë e re), ndërsa për riparimin e pjesëve të njëjta (riparimi i bosh pompës) kishte ofruar çmime të larta. Në faturat e testuara është vërejtur se kompania fituese kishte faturuar vetëm artikujt me vlera më të larta.

Konkluzioni

Menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit jashtë kornizës së aplikueshme juridike rritë rrezikun të mos përzgjidhet operatori më i përshtatshëm ekonomikisht. Kjo mund të dërgoj deri në situata ku mallrat dhe shërbimet e pranuar të mos jenë të kualitetit të kërkuar dhe në këtë mënyrë kompania të mos arrij të realizoj objektivat e synuara.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Menaxhmenti i kompanisë të vendos kontrole rreth procesit të prokurimit, prej fazës së inicimit të procedurave e deri të realizimi i kontratave; dhe
- Me rastin e vlerësimit të ofertave, menaxheri i prokurimit duhet të sigurohet për vlerësimin e tyre profesional në përputhje me kriteret e përcaktuara.

3.2.3. Investimet kapitale

Planifikimi për investime kapitale për vitin 2009 ishte 1,089,003€. Prej tyre janë shpenzuar 987,303€, përkatësisht rreth 91%. Burimi i këtyre mjeteve ishte nga të hyrat e kompanisë në vlerë prej 651,272€, si dhe nga granti i qeverisë prej 336,031€ .

Blerje jashtë kërkesës së aprovuar

Furnizim me Kompjuter dhe mjete tjera të TI-së, në këtë projekt janë blerë më shumë pajisje se sa ishte kërkesa e aprovuar. Tejkalmi ishte për 29 monitorë dhe 2 shtëpiza të kompjuterëve. Gjatë ekzaminimit të depos rreth 100 ditë pas blerjes së këtyre pajisjeve kemi vërejtur se ato ende gjendeshin në depo.

Mungesë e dëshmisë mbi pagesën e ujit dhe vonesa në kryerjen e punëve

Në kontratën **Punime tokësore në rrjetin e ujit dhe kanalizimit**, me rastin e nënshkrimit të kontratës, Operatorit Ekonomik i mungonte dëshmia e kërkuar për pagesën e ujit, pasi që fatura e ofruar nuk ishte në emër të firmës fituese. Po ashtu në këtë projekt fituesi i tenderit është vonuar në kryerjen e punëve për 54 ditë pa ofruar ndonjë dëshmi të arsyeshme.

Konkluzioni

Menaxhmenti i KUR Prishtina nuk ka arritur të menaxhoj shpenzimet për investime kapitale në përputhshmëri të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. Blerja e pajisjeve pa aprovim të kërkesës dhe vonesat në përfundimin e kryerjes së punëve janë shembuj të mungesës së kontrollit të brendshëm. Kontrolltet e brendshme adekuate do të parandalonin veprimet e tilla.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Blerjet të bëhen vetëm në bazë të kërkesave të aprovuara;
- Të mos bëhet nënshkrimi i kontratës pa u ofruar të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas kriterëve të përcaktuara në tender; dhe
- Të aplikohen ndëshkimet për vonesë të pa arsyeshme në kryerjen e punëve.

3.2.4. Menaxhimi i Prokurimit

Kompania ka përgatitur dhe e ka të aprovuar planifikimin e prokurimit për vitin 2009, në të cilin janë paraparë të gjitha aktivitetet e prokurimit, koha e realizimit dhe vlera e tyre e përafërt.

Realizimi i planifikimit të prokurimit për vitin 2009 ishte rreth 30%. Kjo përqindje e ulët e realizimit të planit tregon menaxhim jo të mirë në realizimin e projekteve të planifikuara.

Përveç kësaj ne identifikua edhe disa mangësi në proceset e prokurimit siç janë:

- Blerje jashtë planit të prokurimit rreth 16% në raport me vlerën e planifikuar;
- Mangësi dhe gabime në proceset e vlerësimit, përkatësisht përzgjedhje e firmës fituese në mungesë të tre ofertuesve të përgjegjshëm; dhe
- Mbikëqyrje jo e duhur në realizimin e kontratave e sidomos pagesave.

Shkaku i menaxhimit jo të mirë ishte mos kompletimi i zyrës së prokurimit me staf të mjaftueshëm profesional. Si pasoj, ka raste kur është zgjedhur kontraktuesi jo më i përshtatshëm ekonomikisht duke rrezikuar mosarritjen e vlerës së parasë së shpenzuar.

Konkluzioni

Nga të gjeturat e paraqitura më lartë vijmë në përfundim se procedurat e prokurimit nuk kishin siguruar në mënyre efektive shfrytëzimin e parasë publike. Realizimi i ulët i planifikimit, përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre ofertuesve të përgjegjshëm si dhe mbikëqyrja jo e duhur në realizimin e kontratave janë dështimet kyçe në procesin e prokurimeve.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Në procesin e planifikimit të prokurimit secili departament dhe sektor i kompanisë të parashtrijë kërkesat për nevojat e tyre gjatë vitit;
- Menaxhmenti duhet të përcaktoj prioritetet gjatë përgatitjes së planit të prokurimit në mënyrë që plani të jetë i realizueshëm; dhe
- Të kompletoj Zyrën e prokurimit me staf të mjaftueshëm profesional, në mënyrë që të forcohet kontrolli në menaxhimin e proceseve të prokurimit.

3.3. Menaxhimi i pasurive

3.3.1. Pasuritë Qarkulluese

3.3.1.1. Përdorimi i llogarive bankare dhe paraja e gatshme

Totali i parasë së gatshme në Arkë dhe në Bankë me 31.12.2009 ishte 895,118€.

Ne kemi kryer procedurat e auditimit lidhur me barazimet e parasë ndërmjet regjistrimeve kontabël, ditarëve të arkës dhe ekstrakteve bankare.

Të gjeturat

Auditimi ynë ka shpalosur disa dobësi në menaxhimin e parasë duke filluar nga procesi i inkasimit, mbajtjes së parasë në arkë, si dhe bartjes së tyre deri në bankë. Këto dobësi lidhen me mungesën e një rregullore të qarte, e cila do të sqaronte këto procedura. Mungesa e kësaj rregullore ka shkakuar pasiguri në menaxhimin e parasë në përgjithësi, gjë që përben rrezik në vete për vjedhje dhe keqpërdorim.

Konkluzioni

Të gjeturat e paraqitura më lartë kanë treguar se menaxhmenti nuk kishte arritur të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kontrole të kënaqshme të menaxhimit të parasë duke filluar prej inkasimit të mjeteve e deri të bartja e tyre në bankë.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Të përgatitet një rregullore më e qartë në lidhje me procedurat e menaxhimit të parasë së gatshme, duke filluar nga inkasimi, regjistrimi, bartja e deri të raportimi, si dhe menaxhimi më i mirë i parasë në bankë; dhe
- Të zhvillohen strategji për ekzekutimin e pagesave përmes bankës, të shkurtohet koha e mbajtjes së parasë në arkë dhe të minimizohen inkasimet në të gatshme;

3.3.1.2. Llogaritë e Arkëtueshme

Pasqyrat financiare të Kompanisë kanë prezantuar 7,994,645€ të arkëtueshme për vitin 2009. Ndërsa softueri i kompanisë prezanton të arkëtueshme në vlerë prej 37,289,834€, të cilat janë të akumuluar prej vitit 1999 deri në fund të vitit 2009. Diferencën prej 29,295,188€ kompania i ka deklaruar si borxhe të këqija dhe të dyshimta gjatë këtyre viteve.

Përkundër rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kaluar lidhur më trajtimin e të arkëtueshmeve, kompania nuk ka arritur ta adresoj këtë rekomandim.

Të gjeturat

Nivel i ulët i mbledhjes së të arkëtueshmeve, dhe shpalosje e pamjaftueshme e tyre

Kompania nuk kishte arritur të mbledhë borxhet nga konsumatorët e saj në një nivel të kënaqshëm, që si pasojë niveli i të arkëtueshmeve është shumë i lartë. Ne gjatë auditimit kemi konstatuar se Kompania nuk kishte mbështetje të mjaftueshme nga aksionaret e saj për mbledhjen e tyre.

Pas testeve të mëtejme në konton e llogarive të arkëtueshme kemi vërejtur se ekziston një vlerë prej 99,543€ e cila është e paraqitur me saldo negative. Kjo vlerë gabimisht cilësohet si parapagim i bërë nga konsumatorët.

Po ashtu në periudhën e vitit 2009 kompania ka shlyer borxhe të konsumatorëve në vlerë prej 289,125€, për të cilat mungojnë shpalosjet e duhura dhe baza rregullative mbi procedurat e shlyerjes.

Trajtim dhe vlerësim jo i drejtë i provizionimeve për borxhet e këqija

Në pasqyrat e saj financiare kompania ka prezantuar shpenzime të borxheve të këqija në vlerë prej 2,819,699€, që rrjedh si rezultat i të hyrave të pa inkasuara gjatë vitit 2009.

Paraqitja e kësaj vlere si borxh i keq dhe i dyshimtë nuk ishte në pajtim të plotë me kërkesat e standardeve të kontabilitetit dhe ligjeve tatimore të Kosovës. Kjo kishte ndikuar në rezultatin financiar të kompanisë i cili vazhdimisht prezantohet me humbje.

Konkluzioni

Ne konkludojmë se kompania nuk kishte arritur të siguroj një raportim i cili do të jetë i bazuar plotësisht në standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme tatimore të vendit.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj:

- Marrjen e veprimeve adekuate për mbledhjen e borxheve, duke siguruar mbështetje edhe nga aksionaret e saj, përkatësisht (MEF);
- Shpalosjet e duhura për shlyerjet e të arkëtueshmeve në Pasqyrat Financiare;
- Eliminimin e gabimeve me saldo negative të Llogarive të arkëtueshme të paraqitura në sistem; dhe
- Që trajtimi i të arkëtueshmeve si dhe vlerësimi i provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta të bëhet në pajtim me SNK- SKK dhe ligjet e aplikueshme në vend.

3.3.2. Mjetet themelore

Vlera e mjeteve themelore të kompanisë të paraqitura në Pasqyrat Financiare është 59,943,234€. Ne kemi audituar procedurat e menaxhimit të mjeteve themelore, për sa i takon pranimit, regjistrimit, ruajtjes dhe shlyerjes së pasurisë.

Të gjeturat

Auditimi ynë ka shpalosur të gjeturat në vijim:

- Moduli i mjeteve themelore përmban pasuri të cilat janë në vlerë më të vogël se 500€, e cila bie në kundërshtim me Rregulloren për udhëheqjen e librave në KUR Prishtina. Totali i këtyre mjeteve është 218,083€;
- Në modulën e mjeteve themelore pasuritë nuk janë të evidentuara sipas bar-kodeve; dhe
- Nuk janë bërë shlyerje nga regjistri i mjeteve themelore të pajisjeve të cilat nuk janë funksionale apo kanë dalë jashtë përdorimit.

Konkluzioni

Menaxhmenti nuk ka arritur që të angazhojë një zyrtar për menaxhimin e pasurive përgjatë vitit 2009, që si rrjedhojë mjetet themelore rezultojnë me një numër të gabimeve. Prezantimi i pasurive me vlera më të ulta se 500€, si dhe mos shlyerja e pasurive të cilat janë identifikuar si të papërdorshme janë gabimet kyçe në menaxhimin e mjeteve themelore. Këto gabime ishin cilësuar si gabime teknike dhe nuk ndikojnë në materialitetin e pasqyrave financiare.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të sigurojë që:

- Të bëhet regjistrimi i barkodeve në modulën e mjeteve themelore si dhe të ngarkohet secili i punësuar me pasurinë që e ka në posedim;
- Moduli i mjeteve themelore të mos përmbajë pajisje në vlerë më të vogël se 500€; dhe
- Të shlyhen nga lista kryesore e mjeteve themelore pajisjet të cilat janë identifikuar si jo funksionale nga ana e komisionit për inventarizim.

VIII.4. Kontrolli i brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

Të gjeturat dhe konkludimet tona nga realizimi i buxhetit të KUR Prishtinës të prezantuara më herët tregojnë se sistemet e kontrollit të brendshëm nuk kanë qenë të dizajnuara në mënyrë adekuate për të parandaluar gabimet dhe parregullsitë.

Nga mungesa e kontroleve adekuate janë vërejtur dobësi në:

- Implementimin e plotë të rekomandimeve nga auditimi i vitit të kaluar;
- Nxjerrjen dhe kompletimin e rregulloreve për funksionimin e kontrollit të brendshëm të cilat kërkohen me ligjin e NP-ve;
- Rregulloret e nxjerra nga Kompania lidhur më raportimin financiar të cilat nuk ishin në nivelin e kënaqshëm dhe nuk sigurojnë raportim financiar në përputhje më SNK (apo standardet e pranuar në vend) dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë;
- Kontrollin e procesit të pagesave dhe çertifikimin e tyre;
- Menaxhimin e rrjetit të ujit në disa fshatra dhe në procesin e faturimit në përgjithësi; dhe
- Vlerësimin vjetor të performancës së stafit si dhe në nxjerrjen e rregullave të brendshme të shkruara që do të rregullonin kryerjen e vlerësimit.

Konkluzioni

Të gjeturat e paraqitura me lartë tregojnë se KUR Prishtina nuk kishte arritur të siguroj një kornize ligjore që kërkohet sipas Ligjit të NP-ve, dhe të vendos një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm, të cilat do të ndihmonin kompaninë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Po ashtu mungesa e vlerësimit vjetor të performances së punëtorëve, ka pas ndikim në mos identifikimin e dobësive në performancën e stafit.

Në përgjithësi, ne konsiderojmë se niveli i kontrollit të brendshëm nuk ka qenë i nivelit të kënaqshëm, dhe menaxhmenti i kompanisë duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e tij.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Bordi i drejtorëve të kompanisë duhet të siguroj një kornize të brendshme ligjore e cila do të ndihmoj në funksionimin e kontrollit të brendshëm, dhe do të siguroj menaxhim efikas dhe efektiv të kompanisë;
- Menaxhmenti i kompanisë të dizajnojë dhe të vendosë një sistem funksional të kontrollit të brendshëm, duke kërkuar përgjegjësi dhe raportime të plota nga të gjitha nivelet e kompanisë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; dhe
- Të bëhet vlerësimi vjetor i performances për punëtorët e kompanisë.

VIII.5. Auditimi i Brendshëm

Në zyrën e Auditimit të Brendshëm kompania kishte të punësuar vetëm një auditor (menaxher i zyrës së AB-së).

Megjithatë gjatë periudhës së vitit 2009 auditori i brendshëm kishte arritur të kryej dhjetë (10) auditime në fusha të ndryshme, të cilat e mbulojnë vitin 2009. Këto raporte kishin përfshirë fushën e Pagave, Autoparkun, Stoqet, Të arkëtueshmet, Burimet njerëzore, Paranë e gatshme, Tatimet, Prokurimin si dhe Departamentin për Planifikim dhe Zhvillim.

Këto raporte në vete përmbanin në detaje të gjeturat, ndikimet e tyre si dhe rekomandimet se si menaxhmenti përgjegjës të përmirësoj menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Të gjeturat

Kompania nuk i ka kushtuar shumë rëndësi funksionalizimit të zyrës së auditimit të brendshëm pasi që nuk e ka plotësuar me staf të mjaftueshëm. Po ashtu nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për adresimin e rekomandimeve të nxjerra në raportet e auditorit të brendshëm.

Derisa menaxhmentit nuk kishte përgatitur ndonjë plan për implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm të cilat do të ndihmonin funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Auditori i Brendshëm kishte përfshirë mjaft fusha për auditim, mirëpo mungesa e stafit të mjaftueshëm ndikon që auditimi i brendshëm të mos shtrihet edhe në fusha tjera të rëndësishme dhe me rrezik të lartë.

Konkluzioni

KUR Prishtina nuk i ka kushtuar rëndësi auditimit të brendshëm. Ne kemi ardhur në këtë përfundim pasi që Kompania nuk ka angazhuar staf të mjaftueshëm në këtë Departament, si dhe nuk i kishte dhënë rëndësi të mjaftueshme rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Rekomandimi 11

Rekomandojmë Bordin e KUR Prishtina të siguroj që:

- Kompania të shqyrtoj mundësinë e rritjes së stafit në zyrën e auditimit të brendshëm, duke u bazuar në veprimtarinë dhe operimet e kompanisë; Menaxhmenti të përgatis plane të implementimit të rekomandimeve, të cilat dalin nga raportet e auditorit të brendshëm, ndërsa Komisioni i Auditimit të mbikëqyrë implementimin e tyre; dhe
- Auditori i Brendshëm në planin vjetorë të caktoj prioritetet në bazë të vlerësimit të rrezikut.

IX. Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhimin e Kompanisë

Bordi i Kompanisë nuk kishte arritur të sigurojë një kornizë të brendshme ligjore, si dhe manuale të shkruara të cilat do të ofronin bazë të nevojshme për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të kompanisë. Mungesa kornizës është reflektuar edhe në kontrollin e brendshëm të kompanisë i cili nuk ka funksionuar në mënyrë të kënaqshme.

Problemet kyçe të kompanisë janë lidhur me inkasimin e mjeteve. Gjatë periudhës prej vitit 1999 e deri në vitin 2009 kompania nuk kishte arritur një inkasim të kënaqshëm të mjeteve të saj. Afro 80% e mjeteve të painkasuara kompania i kishte provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta që si pasojë e kësaj pasqyrat financiare të kompanisë gjatë kësaj periudhe kishin rezultuar me humbje.

Kjo dhe dobësitë e tjera të identifikuara në këtë raport lidhur me të hyrat, shpenzimet, menaxhimin e parasë, menaxhimin e pasurive dhe sistemin e kontrollit të brendshëm na kanë shtyrë deri të një konkluzion i përgjithshëm se nevojitet përpjekje e mëtutjeshme nga Boardi për të siguruar një menaxhim më të mirë dhe më kualitativ të kompanisë.

Duke u bazuar në të gjeturat e raportit ne rekomandojmë Boardin e Kompanisë që të rishikoj kornizën e brendshme ligjore si dhe politikat ekzistuese, të analizoj situatën brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, dhe të ndërmerri veprime të mëtutjeshme përmirësuese të cilat do të ndihmojnë kompaninë në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:
(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
(d) është një shpallje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalljeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionin i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngritin opinionin e kualifikuar. i ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionin i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionin i Kundërt. Formulimi i një opinionin të fillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë

prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2

II. Komentet e KUR Prishtinës dhe vlerësimet e ZAP-it

Menaxhmenti të KUR Prishtina i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e auditimit mbi Pasqyrat Financiare për vitin 2009 dhe nuk ka dhënë ndonjë koment.

Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.